



**K.DH.SH.II.nr.958/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A.G. BI me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në Prishtinë, me bazë juridike, vlerësim tatimor, duke vendosur sipas ankesës të ushtruar nga e paditura, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.1783/20, të datës 12.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 18.12.2023, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, e dt.21.12.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.1783/20, i datës 12.10.2021, **Vërtetohet**.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, në pikën I të dispozitivit ka vendosur Aprovohet kërkesëpadia e paditësit A.G. BI me seli në Mitrovicë, si e bazuar. Në pikën II. Anulohet vendimi me nr.319/2020 i datës 01.10.2020 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër këtij Aktgjykimi, në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura ATK, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të; shkeljes së dispozitave procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e të paditurës ATK, të anulohet aktgjykimi i atakuar të anulohet apo çështja të kthehet në Gjykatën e Shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit,nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me Vendimin nr.319/2020 i datës 01.10.2020, në pikën I të dispozitivit Refuzohet si e pabazë ankesa nr.319/2020 e datës

28.09.2020 e subjektit A.G. B.I me numër fiskal NRF:810567191, me pronar A.G., me adresë të biznesit rr. Mbretëresha Teutë - Mitrovicë, në mbështetje të nenit 132/ paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-031 “Për Procedurën e Përgjithshme Administrative”, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 paragrafin të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Në pikën II të dispozitivit Dokumenti i Vendosijes së Ndëshkimit sipas vendimit nr.086/2020 datë 06.08.2020 në vlerë prej (250x14) në vlerë totale 3,500.00€, vërtetohet si i bazuar.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, subjekti tani paditësi, ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në procedurë të konfliktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 11.11.2021, në prani të autorizuarit të palës paditëse si dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas konkludimeve ndër të tjera në arsyetim se; Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ nga forma e vizitës përmbushëse e datës 09.03.2020 dhe nga aktvendimi kontestues, gjykata konstatoi se me datë 09.03.2020 inspektorët tatimor kanë vizituar biznesin me qëllim të verifikimit të pajisjes me arkë fiskale, me ç’rast kanë konstatuar se paditësi nuk posedon arkë fiskale si rezultat i së cilës nuk lëshon kuponë fiskal për shitjet e realizuara. Në bazë të këtyre të gjeturave paditësi është ndëshkuar me katërmbëdhjetë gjoba me nga 250 euro në total 3,500.00€ për shkak të mos lëshimit të kuponëve fiskal në bazë të nenit 56.6 dhe nenit 13.6 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Në arsyetimin e vendimit kontestues Departamenti i ankesave konstaton se përdorimi i arkës fiskale është përshkruar në nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Udhëzimit Administrativ 02/2018 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale si dhe në nenin 4 paragrafi 1.4 të po këtij udhëzimi. Pretendimit të paditësit se Operatorët e Licencuar nuk kanë arka fiskale adekuate, e paditura i është përgjigjur se edhe pse deri më tani nuk ka certifikuar PEF arka fiskale për sektorë të veçantë – Taxi, PEF-ët ekzistues të cilët janë të certifikuar nga operatorët ekonomik mund të përdoren edhe për kategoritë e bizneseve me aktivitet kryesor shërbime taksi apo të ngjashme.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 41 të LKA-së, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e anuluar vendimin nr.497/2019 të datës 05.12.2019 të Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Pretendimet të paditurës se Gjykata e Shkallës së Parë është bazuar në *“kërkesën specifike teknike dhe funksionale për pajisjet elektronike fiskale / sistemet fiskale”* e datës 25.09.2019 e që është paraqitur si provë nga ana e paditësit të dorëzuar në seancën e datës 12.10.2021, Kolegji i kësaj gjykate nuk e pranoj për arsye se gjykata e shkallës së parë e ka konstatuar se pas elaborimit të arsyetimit të vendimit kontestues dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor është paraqitur si provë *“kërkesën specifike teknike dhe funksionale për pajisjet elektronike fiskale/sistemet fiskale”* me numër

protokolli 09.06.3779 të datës 25.09.2019 të nxjerr nga Administrata Tatimore e Kosovës në bazë të nenit 2.2 të Udhëzimit Administrativ 02/2018 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale e i cili parash: “*Arkat Fiskale (AF) janë regjistruar elektronik të arkave që janë të pajisur posaçërisht me memorie fiskale, pllombë fiskale dhe mundësi e pajisje tjera ashtu siç përkufizohen në specifikacionet teknike dhe funksionale të publikuara nga ATK-ja*”. Pikërisht në këtë dokument të paraqitur si provë në gjykatë nga paditësi janë të specifikuara karakteristikat e një arke fiskale për Sistemin Fiskal për Sektorë të veçantë – Taksi. Për gjykatën është i papranueshëm arsyetimi i vendimit kontestues se PEF-ët ekzistues të cilët janë të licencuar nga Operatorët Ekonomik, mund të përdoret edhe për Taksi, kur e paditura nga njëra anë përmes dokumentit nr.09.06.3779 të datës 25.09.2019 ka dhënë specifikat e veçanta të cilat duhet t’i ketë një pajisje fiskale për Taksi, ndërsa nga ana tjetër në arsyetimin e vendimit kontestues edhe pse e pranon faktin se nuk ka operatorë të licencuar për këto Pajisje e obligon paditësin që të pajiset me arkë fiskale jo adekuate për biznesin e tij. Andaj për gjykatën një arsyetim i till është i bazuar dhe pretendimet e të paditurës i refuzon si të pa bazuar dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes.

Pretendimet ankimore të paditurës nga bazat ankimore të theksuara si më lartë si dhe pretendimet e tjera si në arsyetim të ankesës, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara, andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Gjykata e shkallës së parë, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative në vështrim të nenit 43 paragrafi 1, të LKA-së në bazë të këtij parimi Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit e anulon vendimin e kontestuar dhe lëndën e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje, duke e obliguar të paditurën që të deklarohe lidhur me dokumentin me nr. prot. 09.06.3779 të datës 25.09.2019 i nxjerr nga vet e paditura dhe të konstatoj nëse e paditura ka krijuar mekanizëm të posaçëm licencuar apo ka operator për pajisje fiskale speciale për taksi siç pretendon paditësi, dhe varësisht nga gjendja faktike e vërtetuar të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në legjislacionin tatimor. Duke pasur parasysh konstatime, gjykata konkludon se në këtë konflikt administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 paragrafi 2 dhe 65 të LKA-së e detyron të paditurën që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të aktgjykimit.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit

të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.958/22, me datë 18.12.2023**

**Kryetar i kolegjit,**  
**Faton Bajrami**